


KOMUNA - SHITIME

STRATEGJIA  
PËR INFORMIM DHE  
MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN  
2023-2025

Nëntor 2022



Npi – 01/383 datë: 28.11.2022

Në mbështetje të nenit 12.2. pika (c), nenin 40.2 pika (g), dhe nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008); Nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë, Npi – 01/205 datë: 14.07.2017; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Rregulloren e (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunës. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 28.11.2022 miratoi këtë:

## STRATEGJINË

### **PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN PËR PERIUDHËN 2023-2025**

**PËRMBAJTJA** Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.

1.HYRJE .....	2
2.SFONDI .....	3
3.STRUKTURA E ADMINISTRATËS KOMUNALE: .....	4
4.ZYRA KOMUNALE PËR INFORMIM .....	5
5.KORNIZA LIGJORE.....	5
6.GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET .....	7
7.PLATFORMA PËR KOMUNIKIM .....	7
8.VLERËSIMI VETANAK - ANALIZA SWOT.....	8
9.OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT .....	9
10.KANALET E KOMUNIKIMIT .....	11
11.AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR .....	13
12. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË KYÇE.....	18
14.SHTOJCAT.....	16
15.AKTIVITETET E PËRSËRITURA : .....	17
16. BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2023-2025.....	25

## 1.HYRJE

Qeverisja e mirë varet nga jetësimi i suksesshëm i një sërë elementesh kyçe, siç janë transparenca, përfaqësimi, pjesëmarrja, përgjegjësia, llogaridhënia, efektivitetit dhe sundimi i ligjit. Misioni i komunës së Shtimes është që të përqafojë të gjitha këto elemente duke i përkthyer ato në objektiva parësorë të kësaj strategjie. Derisa qeverisja lokale është ngushtë e lidhur me ofrimin e shërbimeve, në asnjë mënyrë nuk mund të neglizhohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesit në të gjitha fazat e ofrimit të shërbimeve – në planifikim, zbatim, monitorim dhe vlerësim. Afërsia që zyrtarët komunal kanë me qytetarët në vetvete kërkon një besim reciprok, i cili mund të ndërtohet dhe kultivohet vetëm përmes një komunikimi të drejtëpërdrejtë, të kohshëm, të hapur dhe pa barriera. Komuna e Shtimes në tri vitet vijuese do t'i japë një vëmendje të merituar praktikave të komunikimit dhe për këtë do të bëhen aranzhimet e nevojshme që të sigurohen burimet e mjaftueshme financiare për të përmbushur objektivat e komunikimit të përcaktuara me këtë strategji. Strategjia për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2025 vendos kornizat e mekanizmit komunikues në mbështetje të krijimit të një kulture administrative që do të mundësojë një progres të dukshëm në disa elemente kyçe të qeverisjes së mirë. Aktivitetet e parapara me këtë strategji vijnë si rrjedhojë e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe siç janë: transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja qytetare, perceptimet dhe kënaqshmërinë e publikut me shumë aspekte komunikuese. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyesë. Po ashtu, përmes kësaj strategjie synohet që të nxitet një bashkëpunim i shëndoshë dhe miqësor me organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e biznesit, komunitetin e donatorëve dhe mediat. Përmes kësaj strategjie, drejtuesit e komunës synojnë që të kenë përfshirje sa më të madhe të personelit të administratës komunale, sidomos në funksion të komunikimit të brendshëm, e me këtë të krijohet një potencial solid në menaxhimin e suksesshëm të komunikimit të jashtëm. Së këndejmi, Strategjia për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2025 është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me akterë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës. Kjo Strategji është vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme për rritjen e cilësisë së komunikimeve në komunë dhe është përpiluar duke marrë parasysh si përvojat e fituara ndër vite, ashtu edhe trendin e zhvillimeve në këtë fushë, sidomos ato që ndërlidhen me komunikimet digjitale.

## 2.SFONDI

### 2.1. Profili i komunës

Territori i komunës është përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave. Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, apo në koordinatat 00.00. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km<sup>2</sup> (13,450.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 për qind të territorit të Kosovës.

Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore – malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore.

Shumica e fshatrave të komunës janë të lidhura me Shtimen me rrugë të asfaltuara. Në bazë të dhënave të marra nga regjistrimi i popullsisë<sup>1</sup> së vitit 2011 publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës shihet se numri i popullsisë në komunën e Shtimes është 27,324 banorë, ku prej tyre 13,850 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore.

Nga këto shifra del se prej 34 komunave, në të cilat është bërë regjistrimi i popullsisë, Shtimja është komuna e njëzet e katërt me radhë për nga numri i banorëve.

Komuna e Shtimës është e përbërë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane:

Belinc, Carralevë, Devetak, Dugë, Davidovc, Gllavicë, Gjyrkoc, Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm, Karaçicë, Llanisht, Mollopolc, Muzeqinë, Pjetërshicë, Lagje e Pajtimit (Petroviq), Petrovë, Raçak, Rancë, Rashincë, Shtime, Topillë, Vojnoc, Zborc

Shtimja është e ndarë në 5 lagje urbane: Shtime I, Shtime II, Shtime III, Shtime IV, Shtime V.


Në bazë të të dhënave të marra nga regjistrimi i popullsisë<sup>2</sup> së vitit 2011, publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, shihet se numri i popullsisë në komunën e Shtimes është 27,324 banorë ku prej tyre 13,850 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore.

---

<sup>1</sup>Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011

<sup>2</sup>Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011

### 3. STRUKTURA E ADMINISTRATËS KOMUNALE:



**Administrata komunale e Shtimes** është e organizuar në 8 drejtori: Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Prokurimit dhe Drejtoria për Inovacion. Në kuadër të administratës komunale, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë njësi organizative, si: Zyra për Financa, Zyra për Informim, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Zyra Ligjore.

#### 4.ZYRA KOMUNALE PËR INFORMIM

ZKI e komunës së Shtimes kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, Drejtorive dhe Njësive të tjera të ekzekutivit. Zyra mban kontakte me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre. Për momentin, në komunën e Shtimes operon një radio-televizion. Në kuadër të funksioneve të saj, ZKI koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit. Më tej, ZKI mirëmban webfaqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë. Vizioni i Komunës për komunikimet Qytetarë të informuar, me mekanizma efikase të komunikimit dhe të pjesëmarrjes në funksion të përgjegjshmërisë dhe transparencës.

#### 5.KORNIZA LIGJORE

Hartimi i kësaj Strategji është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale. Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

**Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040** - obligon Kuvendet e Komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës. Statuti i Komunës së Shtimes përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes

së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

**Rregullorja për transparencë** – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Shtimes dhe të zyrtarëve komunalë për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

**Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215** - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuar nga institucionet publike.

**Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nr.06/L-082** - përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.

**Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna** – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

**Udhëzimi Administrativ nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna** - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

**Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike** - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha uebfaqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunës.

## 6.GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET

Komuna e Shtimes, përmes kësaj Strategjie ka për qëllim që: (1) të avancojë praktikën e komunikimit me audiencën të ndryshme, (2) të përmirësojë efikasitetin e komunikimit dhe ndërveprimin me qytetarë, dhe (3) të krijojë një ambient të përshtatshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Janë të mjaftueshme informacionet që ofrohen mbi buxhetin komunal, shpenzimet buxhetore dhe investimet kapitale. Komuna e Shtimes është e pranishme në platformën sociale Facebook me një numër të konsiderueshëm ndjekësish – 14 mijë. Mbeten akoma hapësirë për përmirësim në drejtim të informimit më të vëllimshëm mbi aktivitete të komunës dhe sidomos informimi i qytetarëve mbi rrjedhat e procesit të hartimit të buxhetit komunal vazhdon të jetë i ulët. Gjithsesi, një hendikep i madh në funksion të informimit të qytetarëve është mungesa e plotë e mediave lokale – qofshin ato tradicionale apo mediat e reja (portalet), por edhe resurset e pakëta joqeveritare që do të mbështesnin një rol më aktiv të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

## 7.PLATFORMA PËR KOMUNIKIM

Komuna e Shtimes e ka për obligim që publikut t'i ofrojë informacione mbi prioritetet, politikat, programet, projektet, strategjitë, shërbimet dhe vendimet e saj. Platforma e komunës për informim dhe komunikim do të mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencën relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Kjo platformë mbështetet në elementet e mëposhtme:

**Transparenca** – Me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë kontekst është transparenca e ushtruar me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

**Llogaridhënia** – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në parimin e llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës, sidomos në çështjet që ndërlidhen me buxhetin, financat dhe shpenzimet e komunës.



**Përgjegjshmëria** – Komunikim i rregullt i autoriteteve komunale me qytetarët që siguron shkallë të lartë të përgjegjshmërisë së udhëheqësve përballë premtimeve, sukseseve dhe dështimeve eventuale të komunës. **Gjithëpërfshirja** – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit.

**Mosdiskriminimi** – nënkupton informim të drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Parimi i mos diskriminimit në të njëjtën kohë nënkupton edhe marrjen parasysh dhe adresimin nga ana e komunës së kërkesave të të gjithëve pa asnjë dallim. **Shumëllojshmëria** – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj. **Informimi me kohë** – nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të kohshëm në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

**Informata kthyesë** – nënkupton ofrimin i mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të përmirësimit të performancës së saj.

#### 8.VLERËSIMI VETANAK - ANALIZA SWOT

<b>PËRPARËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT</b>	<b>DOBËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT</b>	<b>MUNDËSITË PËR RRITJE TË EFIKASITETIT</b>	<b>PENGESAT PËR RRITJEN E EFIKASITETIT</b>
• Aftësia profesionale e Zyrës Komunale për Informim dhe drejtuesve të komunës për të ndërtuar mesazhe të	• Kufizimet në burimet njerëzore dhe financiare për të mbështetur një komunikim më	• Intensiteti i shtuar i përdorimit të platformave për komunikim social. • Përdorimi shtuar i teknologjisë në rritjen	• Mundësitë e kufizuara financiare të komunës për të mbështetur një plan intensiv komunikimi.

<p>qarta dhe koncize për audiencat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i shtuar i mjeteve të avancuara të komunikimit (mediat online dhe platformat sociale, videot, livestreaming, etj.)</li> <li>• Marrëdhëniet e shëndosha me përfaqësuesit e mediave.</li> <li>• Vetëdijesimi në rritje i stafit të administratës komunale mbi rëndësinë e komunikimit efektiv për efekte të informimit dhe zhvillimit.</li> </ul>	<p>intensiv me audiencat e jashtme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e medimeve me frekuencë lokale dhe interesimi i ulët i atyre me frekuenca rajonale apo kombëtare.</li> <li>• Mungesa e kapaciteteve të OJQ-ve lokale për nxitur dhe mbështetur nismat për qytetari aktive dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.</li> <li>• Njohja e ulët e qytetarëve mbi besueshmërinë e lajmeve që plasohen nga mediat.</li> </ul>	<p>e efikasitet në komunikim me audiencat e tjera (grupet profesionale, OJQ-të, institucionet akademike, etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Intensifikimi i vizitave në terren në funksion të informimit, diskutimet dhe ndërgjegjësimit, sidomos në raport me çështjet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen aktive, ambientin, obligimet tatimore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tendenca në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi – në kërkim të sensacionit.</li> <li>• Shpërqendrimi i mundshëm i zyrtarëve të emëruar nga objektivat zhvillimore në prag të (dhe gjatë) fushatave zgjedhore.</li> </ul>
--	--	---	--

## 9.OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Nga sa u tha më sipër, komuna e Shtimes synon që në tre vitet pasuese të ketë personel të mirëinformuar, të respektuar dhe të përkushtuar, të fuqizohet në një institucion të aftë për t'i paraprirë ndryshimeve, të rrisë transparencën, të promovojë ndërveprimin me qytetarë dhe akterë të tjerë, të promovojë me saktësi dhe korrektësi aktivitetet dhe arriturat e veta, si dhe të shtojë dukshmërinë e vet para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik ashtu edhe përmes përdorimit të mediave të reja. Arritja e këtij qëllimi kërkon një mekanizëm solid të komunikimit dhe mesazhe të qarta, të cilat promovojnë vlerat e punës në administratën komunale, inkurajojnë

punën ekipore dhe nxisin idetë inovative. Duke u nisur nga analiza e gjendjes së përgjithshme me komunikim aktual në komunë, synohet avancimi i tyre në të ardhmen dhe shtimi i kapaciteteve financiare dhe njerëzore, Komuna e Shtimes ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

**1. Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale**

**2. Krijimi i mekanizmit efikas për komunikim dhe informim publik**

**3. Rritja e cilësisë së informimit, transparencës, dhe ndërveprimit me qytetarë**

**1. Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale**

Komunikimi i strukturuar dhe koherent brenda administratës komunale dhe me audiencat e tjera të brendshme përbën një aspekt vital në përmirësimin e modelit të komunikimit dhe ndërveprimit. Intervenimet në aspektin e komunikimit të brendshëm do të orientohen në funksion të avancimit të praktikave të bashkërendimit, raportimit dhe përmirësimit të ambientit të punës me qëllim të rritjes së motivimit në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Komuna do të kryejë intervenimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe cilësisë së shërbimeve. Një gjë e tillë do të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (komunikim nga lart-poshtë), shkëmbime ndërsektoriale (komunikim i tërthortë) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (nga poshtë-lart). Kornizat e komunikimit të brendshëm të përcaktuara në kuadër të kësaj strategjie do të shërbejnë si kornizë udhëheqëse për administrimin e komunikimeve dhe do të azhurnohen sipas nevojave dhe në përputhje me vizionin dhe objektivat strategjik të administratës komunale.

**2. Krijimi i mekanizmave efikas për komunikim dhe informim publik**

Komuna e Shtimes do të synojë ribalancim prioritetesh të komunikimit ashtu që vëmendja në të ardhmen të përqendrohet më shumë në promovimin e projekteve dhe programeve konkrete dhe më pak në punët e përditshme rutinore, të cilat tashmë kanë protokolle dhe praktika të mirë-etabluara dhe zhvillohen me efikasitet. Për këtë qëllim, komuna do të shtojë veprimtarinë e vet në drejtim të

promovimit të nismave dhe projekteve konkrete dhe sot të sigurohet që të rrisë nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në të gjitha fazat e zbatimit. Në këtë drejtim do të intensifikohen komunikimet publike, takimet me këshillat e fshatrave, publikimet elektronike me karakter informativ dhe promovues, duke përfshirë edhe buletinet e informimit.

### **3. Rritja e cilësisë së informimit, transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë**

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të instalojë një qasje komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë këtë, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje (përmes zbatimit të plotë të Planit të Transparencës); të ndërtojë marrëdhënie të mira me qytetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e mbështetësit tonë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit përmes mediave të reja, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

## **10.KANALET E KOMUNIKIMIT**

Duke marrë parasysh zhvillimet e mediave të reja dhe kërkesat e kësaj strategjie, Komuna e Shtimes do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat e jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar të publiku. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

**Webfaqja e Komunës [https://kk.rks-gov.net/komuna\\_shtime/](https://kk.rks-gov.net/komuna_shtime/)** mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Vështirësitë e hasura pas ridizajnit të faqes zyrtare të komunës po tejkalohen gradualisht dhe në muajt në vijim ajo duhet të ushqehet me informacionet relevante në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente. Po ashtu, vlen të ceket që seancat e Kuvendit Komunal në Shtime do të vazhdojnë të transmetohen

live në faqe të Facebook-ut dhe të Youtube-s, ku zakonisht përcillen nga qytetarët përmes mundësisë live-stream.

**Mediat online dhe platformat e komunikimit social** - Zyra për Informim do të krijojë lista të konsoliduara për të gjitha audiencat, duke përfshirë edhe mediat tek të cilat synon që të përcjellë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna duhet të kërkojë forma më efikase të komunikimit me to. Në momentin aktual, Komuna e Shtimes është e pranishme vetëm në platformën sociale Facebook. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2023) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

**Paraqitjet publike dhe në media** – janë një formë efikase për t’iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Paraqitjet publike do të intensifikohen sidomos për paraqitjen e sfidave më të rëndësishme të komunës dhe përpjekjet e komunës për t’i adresuar ato.

**Publikimet** - janë një aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara.

**Videot dhe fotografitë** - Rëndësia e imazheve (videot dhe fotografitë) në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe të pashoqëruara me narracion, kanë aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje emocionale.

**Format inovative të takimeve komunitare** – janë një mënyrë e mirë për të rrëzuar barrierat e komunikimit që ndërtohen në nivel komunitar si pasojë e qasjes së munguar në informacion. Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

**Tabelat e informimit** – Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit të qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë te qytetarët të jenë të dukshme dhe të disponueshme për sa më shumë të interesuar.

**Komunikimet ndërinstitutionale** - Institucionet dhe agjencitë e specializuara shtetërore (ministritë relevante të linjës, agjencitë e pavarura shtetërore, institucionet dhe organizatat rajonale, etj.) janë audiencia që kërkojnë një trajtim të klasifikuar për shkak se ndërliohen shumë me kompetencat dhe fushëveprimtarinë e komunës. Komunikimi me audiencia të tilla në të shumtën e rasteve është i natyrave këshilluese dhe koordinuese me synim parësor që të evitohen mospërputhjet, veprimet joligjore apo shkeljet procedurale, e për rrjedhojë edhe rritjen e efikasitetit në punë përmes një qasje më proaktive.

## II. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Shtimes kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e duhura te audiencat e duhura dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit. Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

AUDIENCAT	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?
Personeli i administratës komunale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrata komunale bën gjithçka që është e mundur që të jetë një ambient ku të punësuarit mbahen të informuar, dëgjohen dhe mendimet e tyre respektohen;</li> <li>• Administrata komunale është një ambient ku të punësuarit nxiten që të provojnë që gjërat t'i bëjnë më ndryshe dhe më mirë;</li> <li>• Administrata komunale është një ambient ku secilit i jepet mundësia</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kenë vlerësim pozitiv për informimin mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërliohen me Komunën</li> <li>• Ta ndjejnë vetën të lirë që të dalin me propozime për përmirësimin e mekanizmave të brendshëm dhe rritjen e cilësisë së performancës – individuale dhe ekipore.</li> <li>• Të ndjehen të lirë që të shfrytëzojnë mundësitë për</li> </ul>

	për të zhvilluar kapacitetet profesionale duke shfrytëzuar trajnimet e planifikuara në fillim të çdo viti.	ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale në përputhje me mundësitë e komunës.
<b>Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna e Shtimes është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes.</li> <li>• Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në vendimmarrje.</li> <li>• Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë.</li> <li>• Të kenë mirëkuptim për planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimore.</li> <li>• Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike dhe kontributet e donatorëve dhe partnerëve.</li> </ul>
<b>Mediat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna është e hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja.</li> <li>• Komuna i shpenzon paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës.</li> <li>• Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe keqqeverisjes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit.</li> <li>• Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të saktë, të sinqertë dhe të paanshme.</li> <li>• Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës</li> </ul>
<b>Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat profesionale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale</li> <li>• Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre.</li> <li>• Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje.</li> <li>• Të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve komunale.</li> </ul>
<b>Komuniteti i biznesit dhe investitorët e mundshëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna e Shtimes nxit krijim e një ambienti miqësor për biznes.</li> <li>• Administrata komunale është e përkushtuar që të rrisë nivelin e cilësisë së shërbimeve.</li> <li>• Komuna synon të jetë një vend i mundësive dhe nxitëse e inovacionit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre.</li> <li>• Të kontribuojnë profesionalisht në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore.</li> <li>• Të inkurajojnë investitorët e huaj të investojnë në komunën e Shtimes.</li> </ul>
<b>Institucionet e Kosovës (Qeveria, Kuvendi i Republikës,</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna e Shtimes është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes.</li> <li>• Komuna e Shtimes i mirëpret dhe i shfrytëzon kontributet e donatorëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të flasin me pozitivitet mbi bashkëpunimin dhe partneritetin me komunën.</li> <li>• Të na mbështesin në avokimin për grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore.</li> </ul>

agjencitë qeveritare, etj)	në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. • Komuna e Shtimes është një partner i besueshëm që kujdeset për qëndrueshmërinë e projekteve dhe investimeve.	Të përdorin autoritetin e tyre për më shumë fonde për komunën. • Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes dhe demokracisë.
----------------------------	---	---

### 13. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË KYÇE

Kryetari i Komunës	Promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme. Siguron zbatimin efikas të kësaj Strategjie.
Kryetari dhe Zyrtaari i lartë për informim	Mbikëqyrin zbatimin e Strategjisë për Komunikim Janë përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.
Drejtorët e drejtorive komunale	Promovojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj. Furnizojnë Zyrën për Komunikim me Publikun me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut. Koordinohen me Zyrën për Komunikim me Publikun dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik. Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëheqin me zhvillimet që ndërlihen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës dhe inkurajojnë shprehjen e lirë të tyre në planifikim dhe vendimmarrje.
Zyra për Komunikim me Publikun	Është përgjegjëse për të mirëmbajturin e faqes zyrtare të komunës në internet dhe llogarive në platformat sociale. Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunës. Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm. Në



	bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës. Sigurohet që të punësuarit e administratës dhe audiencat tjera të kenë informacionet e nevojshme mbi ngjarjet që ndërlidhen me ekzekutivin e komunës.
Të punësuarit në administratën komunale	Kontribuojnë në format që zgjedhin ata për të përmirësuar praktikën e komunikimit në administratën komunale. Bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive me eprorët e tyre në funksion të përmirësimit të komunikimit

#### 14.SHTOJCAT

Shtojca 1. Plani i veprimit për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2025

#### **OBJEKTIVI 1: AVANCIMI I PRAKTIKAVE TË KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM NË ADMINISTRATËN KOMUNALE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)**

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
Hartimi i Udhëzuesit për komunikim me email zyrtar	Kryetari, Zyra për Informim	Janarit 2023-2025	Pa kosto shtesë
Takimi i Përgjithshëm (1) me stafin e administratës	Kryetari, Njësia e Personelit	Shkurt 2023-2025	Pa kosto shtesë
Azhurnimi i Programit për Trajnime dhe ngritje profesionale	Kryetari i komunës, drejtorët, Njësia e personelit	Mars 2023-2025	Pa kosto shtesë
Përpilimi i listës së nevojave të personelit për pajisje në vendin e punës	Kryetari drejtor i administratës, Zyra IT	Prill 2023-2025	Pa kosto shtesë
Takimi i Përgjithshëm (2) me stafin e administratës	Kryetari i komunës Njësia e personelit, drejtorët	Qershor 2023-2025	Pa kosto shtesë
Konferenca Vjetore (gjithëditore) me pjesëmarrjen e zyrtarëve me përgjegjësi	Kryetari i komunës Drejtorët e drejtorive	Nëntor 2023-2025	900.00 € (për tri vite)

menaxhuese në komunë			
Vlerësimi i zbatimit të planit vjetor të komunikimit	Kryetari i komunës, zyra për informim	Dhjetor 2023-2025	Pa kosto shtesë
Takim përmbyllës me personelin dhe mysafirë të ftuar	Kryetari i komunës Drejtorët e drejtorive, Zyra për informim	Dhjetor 2023-2025	1500.00 € (për secilin vit)

15. AKTIVITETET E PËRSËRITURA :

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FREKUENC
Takimet e drejtorëve të drejtorive me zyrtarët e linjës	Drejtorët e drejtorive	Në baza javore
Raportet e konsoliduara periodike të administratës komunale	Kryetari komunës	Në baza mujore
Takimet e bordit të drejtorëve	Kryetari i komunës, Drejtorët e drejtorive komunale	Në baza javore
Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës	Kryetari komunës, zyra për informim	Sa herë që ka zhvillime që ia vlejné të ndahen me të punësuarit (arritje, ngjarje, këshillime, etj.)
Takimet bashkërenduese të kryetarit me kryesuesin e Kuvendit dhe komitetet obligative	Kryetari, Njësia e Kuvendit të Komunës	Para secilës seancë dhe sipas nevojës

KOSTOJA PROVIZORE: 5,400.00€

**OBJEKTIVI 2: KRIJIMI I MEKANIZMIT EFIKAS PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM PUBLIK (AKTIVITETE TË VEÇANTA)**

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
Vlerësimi i zbatimit të Planit të Transparencës për vitin e kaluar	ZKI, Kabineti i Kryetarit	Janar 2023-2025	Pa kosto shtesë
Hartimi i Planit për dëgjimet, konsultimet dhe debatet publike në lidhje me procesin e buxhetit komunal	ZKI, Kabineti i Kryetarit Kuvendi Drejtoritë komunale	Prill 2023-2025	Pa kosto shtesë
Takim koordinues me organizatat e shoqërisë civile – Tema: Bashkëpunimi reciprok në transparencën e Komunës dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje	Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit të Komunës, ZKI	Maj 2023-2025	500.00€ (për secilin vit)

Sondazh në webfaqe dhe Facebook mbi preferencat e qytetarëve për projekte madhore publike.	ZKI, Drejtoritë	Qershor 2023-2025	Pa kosto shtesë
Organizimi i formave të reja/inovative të dëgjimeve dhe konsultave publike në përputhje me Doracakun për Standardet Minimale për Organizimin e Konsultimeve Publike	ZKI, Drejtoritë	Korrik 2023-2025	4000.00€ (për tri vite)
Formimi i grupit profesional për analizën e performancës së komunës sipas raporteve të MAPL dhe organizatave vendore e ndërkombëtare	Nënkryetari i Komunës, Drejtoritë komunale ZKI	Tetor 2023-2025	Pa kosto shtesë
Përpilimi i listës së veprimeve për mënjanimin e mangësive të evidentuara nga raportet e performancës	Grupi profesional	Nëntor 2023-2025	Pa kosto shtesë

Kostoja preliminare: 5,500.00 E

**OBJEKTIVI 3: RITJIA E CILËSISË SË INFORMIMIT, TRANSPARENCËS, DHE NDËRVEPRIMIT ME QYTETARË (AKTIVITETE TË VEÇANTA)**

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
Publikimi i Buletinit vjetor të komunës	Kabineti i Kryetarit ZKI	Dhjetor 2023-2025	3000.00 (për tri vite)
Ndërhyrjet në perditesimin e websajtit te komunës për organizimin dhe ritjen e resurseve humane dhe kapacitetet teknike per permiresimin e menyres se shperndarjes se informacioneve, sipas rekomandimeve te MAPL-se	ZKI, Zyrtari IT	Janar 2023-2025	Pa kosto shtese
Hartimi dhe prodhimi i fletëpalosjeve për mbrojtjen aktive të ambientit	ZKI, Drejtoria e Administratës Publike	Mars 2023-2025	400.00 (për secilin vit)
Hartimi dhe prodhimi i fletëpalosjes për obligimet tatimore dhe të hyrat vetanake të komunës	ZKI Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Prill 2023-2025	400.00 (për secilin vit)
Konferenca e Kryetarit të komunës për paraqitjen e Raportit Vjetor	Kryetari i Komunës, ZKI	Prill 2023-2025	Pa kosto shtesë
Takim koordinues me përfaqësuesit e organizatave dhe donatorëve që mbështesin Komunën	Kryetari i Komunës ZKI	Qershor 2023-2025	750.00 (për secilin vit)
Takim tematik i kryetarit të komunës me organizatat e shoqërisë civile	Kryetari i Komunës, ZKI	Korrik 2023-2025	Pa kosto shtesë
“Dita e Dyerve të Hapura per mergaten” të Komunës	Kryetari i Komunës ZKI	Korrik 2023-2025	300.00 (për secilin vit)
Prodhimi i një videoje promovuese me tiparet/lokacionet më atraktive të Komunës	ZKI	Gusht 2023-2025	400.00 (për secilin vit)

Standardizimi i njësive të identitetit vizual të komunës (salla e konferencave, flamuri, broshurat, posterat, dosjet, fletoret, tabelat informuese, etj)	Kabineti i Kryetarit, ZKI	Tetor 2023-2025	600.00 (për secilin vit)
Emërimi i grupit punues për hartimin e buletinit vjetor të komunës	Kryetari i Komunës	Nëntor 2023-2025	Pa kosto shtesë

#### AKTIVITETE TË PËRSËRITURA:

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	SHPESHTËSIA
Komunikata për shtyp	Kabineti i Kryetarit ZKI	Gjatë gjithë kohës
Intervista dhe prononcime	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive ZKI Personat e autorizuar	Gjatë gjithë kohës dhe sipas autorizimeve Gjatë gjithë kohës dhe sipas autorizimeve
Mirëmbajtja e webfaqes komunale dhe llogarive në platformat sociale	ZKI Drejtoritë	Gjatë gjithë kohës
Reklama/Shpallje	Kabineti i Kryetarit Njësia e Personelit Drejtorët e drejtorive ZKI	Sipas rastit dhe nevojës
Takime të Kryetarit të komunës me komunitetin	Kryetari i Komunës Këshilltari për media ZKI	Një herë në muaj
Publikimi i dokumenteve në websajt në përputhje me dispozitat ligjore	ZKI	Gjatë gjithë kohës
Aplikimi i formave të reja/inovative të takimeve dhe konsultave publike në përputhje me Doracakun për Standardet Minimale për Organizimin e Konsultimeve Publike	KPF/Administrata Kuvendit Kryetari Komunës ZKI	Gjatë gjithë kohës
Organizimi i dëgjimeve buxhetore në përputhje me tiparet dhe karakteristikat e audiencave	KPF/Administrata Kuvendit Kryetari Komunës ZKI	Gjatë gjithë kohës

Kostoja preliminare: 8.100.00 EURO

## 12. BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2023-2025

OBJEKTIVI	KOSTOJA(€)
(1) Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale	5.400.00€
(2) Krijimi i mekanizmit efikas për komunikim dhe informim publik	5,500.00€
(3) Rritja e cilësisë së informimit, transparencës, dhe ndërveprimit me qytetarë	8.100.00€
<b>Gjithsej</b>	<b>19,000.00€</b>

- Implementuesit e strategjisë për informim dhe marrëdhënie me publikun në Komunën e Shtimes 2023-2025 janë Ekzekutivi dhe të gjitha Institucionet në nivelin Komunal.
- Kjo Strategji hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes. Ndërkaq implementimi i saj do të fillojë nga dita e hyrjes në fuqi.

